Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS PËR VITIN 2019

Prishtinë, Qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Ministrisë së Infrastrukturës*, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Mjellma Dibra Morina - udhëheqëse e ekipit, dhe Fanol Hodolli, Natyra Kasumaj dhe Antigona Çitaku anëtarë të ekipit,* nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Zukë Zuka*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....6

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore....7

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....12

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....36


Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja....42

Shtojca II: Letër e konfirmimit....44

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Në draft PVF-të e MI ishin të nevojshme disa korrigjime financiare. Ne kemi dhënë disa sugjerime për të rishikuar shpalosjet përshkruese dhe për të siguruar plotësinë e shpalosjeve si në vijim:

(a) Neni 16 Llogaritë e arkëtueshme - nuk ishte prezantuar drejt, pasi që në gjendjen përfundimtare të fundvitit nuk ishin përfshi edhe obligimet e viteve paraprake; dhe

(b) Mangësi tek shënimet dhe shpalosjet, si:

- Shënimi 6 për shpenzimet kapitale tek tabela, nuk është ndarë në kolonë të veçantë shuma e pagesave të realizuara nga 'Të hyrat nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)' por janë përfshirë në total te shuma e Grantit Qeveritar;
- Sa i përket avanseve, nuk ishin dhënë informacione të mjaftueshme;
- Neni 19.3.1 (Pasuritë kapitale me vlerë mbi 1000) nuk është bërë klasifikimi i pasurive sipas formatit të Raportit Vjetor (Udhëzimit të Thesarit);
- Informacionet shpjeguese për shumat e prezantuara në shpalosje nuk përmbajnë detaje rreth projekteve kapitale, si dhe sqarime rreth progresit të projekteve të financuara nga fondet e jashtme; dhe
- Neni 17 detyrimet e pa paguara, nuk janë paraqitur drejtë.

Si rezultat i rekomandimeve të dhëna në fazën e rishikimeve analitike, janë bërë rregullimet në draft pasqyrat vjetore financiare të paraqitura për auditim, përveç, tek Neni 14 – Raporti i ekzekutimit të buxhetit – të hyrat jo tatimore ishin prezantuar si të hyra të dedikuara si dhe mos paraqitja e drejtë e detyrimeve.

Në aspektin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ekzistojnë shumë fusha ku nevojiten përmirësime në mënyrë që të ngritët përgjegjësia dhe llogaridhënia. Theks të veçantë në fushën e përmirësimeve duhet vendosur në ndarjen e detyrave sipas përgjegjësive dhe ekzekutimin e buxhetit.

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve për vitin 2018, rezulton se 8 nga 16 rekomandime ende nuk janë adresuar fare. Krahas zbatimit relativisht të ulët të rekomandimeve, Ministria nuk ka raportuar lidhur me Progresin për zbatimin e rekomandimeve. Rrjedhimisht, Ministria nuk ka të vendosur një proces për menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Si rezultat i kësaj, dobësi të vazhdueshme po identifikohen vit pas viti, me theks në menaxhimin e shpenzimeve si dhe efikasitet të ulët në realizimin e investimeve kapitale.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm[1]

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore të MI për vitin 2019 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale:

Theksim i çështjes:

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për çështjet në vijim:

(a) Kompensimit të pagave në vlerë prej 156,151€, për 32 zyrtarë pa vijueshmëri në punë;

(b) Kompensimit të shtesave retroaktive nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 91,909€;

(c) Keqklasifimit të pagesave në vlerë prej 289,685€ në kategori ekonomike jo adekuate.

Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të këtij Raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë, gjatë procesit të auditimit.

[1] Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për çështjet si në vijim:

1. *Kompensimi i pagave pa vijueshmëri në punë*

Bazuar në vendimin e Qeverisë nr. 06/39 i dt. 22.07.2015, MI ka të angazhuar 32 punonjës (në njësitë e sajë në komuna), për të cilët nuk ka dëshmi që konfirmojnë vajtje-ardhjen e tyre në punë ashtu siç i obligon Rregullorja nr. 05/2010 e orarit të punës. Mos vijueshmëria në punë është konfirmuar edhe nga vetë ministria. Ministria kishte bërë pagesën e rregullt të pagave të tyre gjatë tërë vitit, dhe vlera totale e pagave të paguara për këta zyrtarë ishte 156,151€.

2. *Pagesa e shtesave retroaktive nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve jashtë kërkesave për ndarje buxhetore.*

Sipas Rregullores 33/2012, Neni 10 Kushtet dhe planifikimi i buxhetit për pagesën e shtesave dhe kompenzimeve: pika 1. Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet dhe aprovimin paraprak nga Ministria përgjegjëse për Administratës Publike, dorëzojnë në Ministrinë përgjegjëse për financave shumën buxhetore të nevojshme për shtesa, kompensim dhe pagesat e tjera për institucionin përkatës relevant; 2. Çdo shtesë dhe kompensim e përcaktuar me këtë Rregullore nuk mund të realizohet, nëse nuk është e planifikuar në buxhetin vjetor të institucionit përkatës, dhe 3. Çdo shtesë dhe kompensim tjetër, që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore, është e palejueshme.

Shtesat mbi pagën bazë janë aprovuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm (SP), duke anashkaluar bazën ligjore mbi ndarjet buxhetore. Pagesat ishin ekzekutuar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve. Vendimi për aprovim të shtesave, bazohet në Rregulloren për Administrimin e Fondeve të Huamarrjes[2] edhe pse në disa raste të punësuarit nuk ishin pjesë e Njësive për Zbatimin e Projekteve (NjZP):

- Kompensimi i të punësuarve në NjZP për autostradën Prishtinë-Hani i Elezit, është bërë sipas vendimit të nxjerrë nga Ministri i Infrastrukturës me datën 21.06.2018 në emër të Komitetit Drejtues Ndërministror bazuar në kërkesën e aprovuar nga SP. Kërkesa bazohet në Rregulloren 33/2012 neni 13 paragrafi 4[3] (për perfeksionim profesional të specializuar) si dhe në Rregulloren 05/2017 për Administrimin e fondeve të huamarrjes, edhe pse këto dy akte nuk ishin relevante për rastin. Ky vendim përcakton zbatimin e tij për pagesa në mënyrë retroaktive, për pozitat e emëruara me vendimin (2778/14) të datës 15.09.2014, kompensimi bëhet duke filluar nga janari 2018, ndërsa për pozitat e emëruara me vendim (2199) të datës 09.03.2018, kompensimi bëhet nga marsi 2018.

  Në dy pagesa të testuara, kemi vërejtur se pagesa është ekzekutuar bazuar në vendimin e datës 15.09.2014. Pagesat ishin në vlerë 36,616€ dhe 27,468€. Megjithatë, MI nuk ka ofruar dëshmi se të angazhuarit, në pajtim me vendimin, kishin kontratë të veçantë për angazhimin në NjZP.

- Sipas vendimit 247/17 datë 17.05.2017 për themelimin e NjZP-së Prishtinë-Gjilan-Dheu i bardhë, nuk parashihet kompensimi i të angazhuarit për menaxher të kësaj njësie. Megjithatë, sipas marrëveshjes (19.03.2019) së lidhur mes SP dhe të punësuarit, është përcaktuar menaxheri i NZP-së, ashtu që angazhimi të filloj prej datës 17.05.2017. Për kohën sa i punësuari ishte i angazhuar me një pozitë të rregullt i ishte kompensuar vetëm

[2] Rregullore nr. 01/2016 për administrimin e fondeve të huamarrjes, me plotësim ndryshimet 03/2017 si dhe 05/2017.

[3] Rregullore 33/2012 Neni 13 Kompensime të tjera në raste të veçanta Paragrafi 4, Kompensimet për perfeksionim profesional të specializuar, për nevoja të institucionit ose të shtetit, mbulohen nga institucioni, nëse nuk mbulohen nga ndonjë organ tjetër 4.1 Përpos kompensimeve të parapara sipas paragrafit 4 të këtij neni, nëpunësit civil, gjatë kohës së perfeksionimit profesional, nuk i humbet e drejta në pagë të rregullt mujore.

ndryshimi me pagën e rregullt. Kompensimi në vitin 2019 ishte ekzekutuar në mënyrë retroaktive në vlerë totale prej 19,328€, duke u bazuar në datën e angazhimit të punësuarit.

- Kompensimi me shtesë i personelit të rregullt të Ministrisë i cili është ekzekutuar me kërkesë të Drejtorit për Buxhet dhe Financa dhe me aprovim nga SP i kësaj Ministrie. Sipas vendimit kompensimi i ndahet zyrtarëve të angazhuar në punë shtesë për përgatitjen dhe implementimin e pagesave të projekteve të financuara nga huamarrjet e jashtme. Sipas vendimit obligohet zbatimi i tij në mënyrë retroaktive duke filluar nga 01.01.2019 për kompensimin e 14 zyrtarëve të MI-së duke përcaktuar shumën e shtesës. Mostra e testuar përfshin pagesën për dy muajt e parë të vitit sipas këtij vendimi për njërin nga zyrtarët në vlerë 899€. Ndërkohë, nuk ka dëshmi që krahas angazhimeve ditore të zyrtarëve janë dokumentuar angazhime shtesë. Në mesin e zyrtarëve të kompensuar ishte edhe një zyrtare e cila ishte e angazhuar në NjZP me vendim të SP me pagë fikse për periudhën e përfshirë, që i bie se për punën e njëjtë është kompensuar edhe me një shtesë (899€ për dy muaj).
- Kompensimi i anëtarëve të Komisionit për mbikëqyrjen e projekteve kapitale të MI-së. Vendimi i nxjerrë nga SP me datë 11.06.2019 bazohet në Ligjin 06/L-133 për ndarjet buxhetore për vitin 2019 neni 20 dhe shtesa përcaktohet duke u thirrur në Rregulloren 05/2017[4]. Të dy këto akte i referohen NjZP-ve të cilat merren me menaxhimin e aktiviteteve për projektet e financuara nga huamarrjet, derisa anëtarët e këtij komisioni nuk janë pjesë e NjZP-ve . Vendimi obligon zbatimin retroaktiv të pagesave për shtesa, duke filluar nga data 07.06.2018. Mostra e testuar përfshin pagesën për 15 muaj të njërit nga anëtarët e Komisionit në fjalë në vlerë prej 7,597€.

3. Realizimi i pagesave në kategori ekonomike jo adekuate

Gjatë vitit 2019, për mirëmbajtjen e rrugëve janë kryer pagesa në vlerë prej 283,619€, mirëpo këto pagesa nuk e përmbushin kriterin për tu cilësuar si investime kapitale. Këto pagesa përmbajnë elemente të natyrës së mallrave dhe shërbimeve, si: monitorimi dhe inspektimi, largimi i ujërave, largimi i automjeteve të aksidentuara, furnizimi me kripë, pastrim i rigollave, skajorëve dhe trotuareve etj. Shuma e llogaritur është nxjerrë nga pozicionet e librit ndërtimor. Të njëjtat pagesa kishin ndikuar në regjistrat e pasurisë duke i mbivlerësuar ato. Këto shërbime ishin planifikuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe buxhetuar nga Ministria e Financave si investime kapitale. Nga ZKF dhe Departamenti për menaxhimin e rrugëve, nuk është bërë ndarje në mënyrë specifike e mirëmbajtjes investive dhe asaj rutinore. Po ashtu, blerja e një 'switch'-i (pajisje shpërndarëse e rrjetës kompjuterike) në vlerë prej 4,950€ dhe një laptop në vlerë 1,116€ janë regjistruar në kodin ekonomik 13503 'Kompjuterë më pak se 1,000' nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa duhej të regjistrohej si investime kapitale.

[4] Rregullore 05/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores MF-Nr. 01/2016 për administrimin e fondeve të huamarrjes, e plotësuar dhe ndryshuar me rregulloren MF-Nr 03/2017, e nxjerrë nga Ministri i Financave.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në faqen zyrtare të ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore.

Rekomandimi A1 Ministri të siguroj se në rastet e kompensimeve të personelit, të ndiqet mënyra e rregullt e pagesës së shtesave, se shtesat janë buxhetuar në kategorinë e duhur, si dhe të shqyrtohen vendimet e marra dhe të sigurohet se Ministria ka ndërmarrë veprimet e duhura ligjore.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2020 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet e keqklasifikimeve, prezantimit të të dhënave te raportimi i ekzekutimit të buxhet si dhe shpalosjeve në PVF.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Megjithëse janë vërejtur përmirësime të dukshme sa i përket fushës së prokurimit sidomos lidhur me respektimin dhe zbatimin e kërkesave në dobi të një planifikimi dhe menaxhimi të drejtë të nevojave të Ministrisë, mangësitë janë të theksuara në menaxhimin e kontratave të prokurimit, menaxhimin e shpenzimeve lidhur me projektet e financuara nga huamarrjet, bashkëfinancimet me komunat, menaxhimin e personelit si pasojë e moszbatimit të drejtë të procedurave si dhe menaxhimin e pasurisë dhe llogaritë e arkëtueshme.

Në kuptimin e sistemeve financiare, duhet të forcohen kontrollet mbi ekzekutimin e shpenzimeve, realizimit të buxhetit me theks tek investimet kapitale ku ende ka vonesa në implementimin e projekteve sidomos ato të financuara nga huamarrjet. Ministria edhe më tej nuk ka arritur të vendos kontrollet e duhura për menaxhimin e obligimeve financiare, dhe për këto arsye, ende ka mangësi në raportimin dhe pagesën me kohë të këtyre obligimeve.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[5]	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**301,487,751**	**301,373,981**	**196,989,433**	**65%**	**244,826,294**	**234,379,056**
Granti i Qeverisë	141,137,251	141,023,481	124,357,256	88%	166,079,589	234,309,830
Të hyrat nga AKP	65,550,500	65,550,500	62,646,477	96%	74,453,333	0
Financimet nga huamarrjet	23,300,000	23,300,000	9,985,700	43%	4,293,372	69,226
Klauzola e investimeve	71,500,000	71,500,000	0	0%	0	0

[5] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Buxheti final i Ministrisë në raport me atë fillestar kishte pësuar një zvogëlim (113,770€) i cili kishte ardhur si rezultat i vendimeve të Qeverisë apo ndryshimet e reflektuara për plotësimin e kërkesave buxhetore. Megjithatë, buxheti në fund të vitit kishte rezultuar me një tepricë buxhetore prej 104,384,548€.

Realizimi i ulët i shpenzimeve ndikohet nga projektet e planifikuara nga burimet e financimit të huamarrjes dhe klauzolës së investimeve. Mos zbatimi i tyre lidhet me vonesat në themelimin e Njësive Zbatuese të Projektit. Mjetet nga klauzola e investimeve ishin destinuar për projektet: (1) Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës magjistrale M9 Prishtinë-Pejë – 45,000,000€, (2) Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale – 15,000,000€, (3) Rehabilitimi i linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Hani i Elezit – 10,000,000€ dhe (4) Projekti i sigurisë së trafikut dhe transportit – 1,500,000€.

Në vitin 2019, Ministria ka shpenzuar 65% të buxhetit final ose 196,989,433€, me një ulje prej 14% krahasuar me vitin 2018. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**301,487,751**	**301,373,982**	**196,989,433**	**65%**	**244,826,294**	**234,379,056**
Pagat dhe Mëditjet	1,925,977	1,812,208	1,812,208	100%	1,829,911	1,743,492
Mallrat dhe Shërbimet	8,103,323	8,453,323	8,371,109	99%	6,594,681	5,776,727
Shërbimet komunale	375,190	375,190	145,970	39%	154,243	137,337
Subvencionet dhe Transferet	1,443,814	1,878,814	1,502,676	80%	1041,743	1,442,658
Investimet Kapitale	289,639,447	288,854,447	185,157,470	64%	235,205,716	225,278,842

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti për paga dhe mëditje ishte reduktuar si rezultat i kursimeve buxhetore. Përderisa, buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 350,000€. Duhet theksuar se ekzekutimi i buxhetit nga kjo kategori ishte i rritur në tre mujorin e parë dhe të dytë ku pjesa më e madhe e buxhetit të ndarë ishin shpenzuar kryesisht në këtë periudhë. Rritja e buxhetit vjen si rezultat i rritjes së shpenzime nga shërbimet kontraktuese dhe numrit të personelit të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta. Ndërsa, lëvizje buxhetore kishte pasur edhe në kategorinë e investimeve kapitale me ç'rast ishte zvogëluar kjo kategori për 785,000€ si rrjedhojë e vendimeve për kursimet buxhetore. Por, edhe përkundër kësaj, realizimi në këtë kategori ishte i ulët. Kjo ishte ndikuar kryesisht për shkak të ngecjes së projekteve të financuara nga huamarrjet dhe klauzola e investimeve.

MI, kishte planifikuar të financonte 300 projekte kapitale në vitin 2019. Prej tyre 88 ishin projekte të reja, ndërsa 94 projekte të cilat ishin planifikuar, nuk kishin filluar fare. Një pjesë e këtyre mjeteve ishin transferuar tek projekte tjera.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MI në 2019 ishin në vlerë 3,514,990€. Ato kanë të bëjnë me: Të hyrat e realizuara Taksa për leje të vozitjes, Licencat për afarizëm, Taksat administrative, Licencat për aktivitete individuale të lira, Gjobat nga inspektorati e të tjera.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	2,494,700	2,494,700	3,514,990	141%	2,805,710	2,510,869
Totali	**2,494,700**	**2,494,700**	**3,514,990**	**141%**	**2,805,710**	**2,510,869**

Të hyrat e realizuara nga MI depozitohen në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në SIMFK në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit, dhe nuk janë të autorizuara për shpenzim të MI-së.

Nga të hyrat e realizuara, kemi testuar tetë (8) mostra substanciale në vlerë 36,230€, dhe tetë (8) mostra për teste të pajtueshmërisë. Me rastin e ekzaminimeve të këtyre mostrave, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi për ta raportuar.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga ishte 1,812,208€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 308 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 285. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar gjashtë zyrtarë të rinj. Ne kemi testuar shtatë (7) mostra për teste substanciale, si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2-Mangësi në procedura të rekrutimit

Gjetja

Duke u bazuar në Rregulloren e procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil Neni 41, Paragrafi 1 thekson që Menaxheri i Personelit të institucionit rekrutues e njofton me shkrim kandidatin e suksesshëm mbi të drejtat e tyre mbi emërim. Njoftimi gjithashtu përcakton se Akti Zyrtar i Emërimit do lëshohet brenda 30 ditësh. Gjithashtu, Neni 41 paragrafi 2, thekson se Njoftimi përmban emrat e kandidatëve të suksesshëm, vendin e punësimit dhe pikët e fituara gjatë procedurës së përzgjedhjes.

Në tre (nga gjashtë) procese të testuara të rekrutimit ne kemi hasur mangësi në procedura.

Në Departamentin për patent shofer, me datën 25.06.2019 ishin shpallur dy pozita të lira për Zyrtar Administrativ. Divizioni i personelit ka bërë njoftimin me datë 23.07.2019 për kandidatët e suksesshëm në web faqe të MI-së, të cilët ishin dy, dhe në pajtim me vlerësimin dhe rekomandimin nga komisioni i KPSHC dhe aprovuar nga Sekretari i Përgjithshëm (SP). Megjithatë, me datë 23.08.2019 në web faqe të ministrisë, me kërkesë të zyrtarit të lartë ekzekutiv të SP, ishte shpallur njoftimi për anulimin e konkursit. Njoftimi për anulim i publikuar në web faqe të MI, është bërë një ditë pas mbylljes së afatit ligjor[6] dhe nuk përmban arsyeshmëri të anulimit, as datë apo numër protokolli. Njoftimi për anulim nuk specifikon se është anuluar vetëm një pozitë, pasi që tashmë njëra kandidate kishte nënshkruar aktemërimin, por si anulim i konkursit në tërësi. Kandidatja e cila është përzgjedhur për pozitën e dytë, është informuar përmes këtij njoftimi se konkursi është anuluar dhe e njëjta ka ushtruar të drejtën e ankesës.

Zyrtarët përgjegjës nuk ishin në gjendje të ofrojnë dëshmitë rreth arsyeshmërisë së anulimit të pjesshëm të konkursit. Në anën tjetër, anulimi i konkursit të bërë ka ndodhur si pasojë e kërkesës së zyrtarit të lartë ekzekutiv përmes SP dhe pa arsyeshmëri.

Ndikimi

Anulimi i konkursit pa një vendim me arsyeshmëri të bazuar mund të ndikoj në paraqitjen e rasteve pranë organeve kompetente si pasojë e mos zbatimit të kërkesave ligjore.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të dispozitave ligjore të sipër përmendura në lidhje me procedurat e rekrutimit dhe anulimin e konkursit, dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës për veprimet apo mos veprimet e tyre të nevojshme për të siguruar kompetencën profesionale për zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.

[6] 31 ditë nga data 23.07.2019-23.08.2019

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime, përfshirë komunalitë, në vitin 2019 ishte 8,828,513€, prej të cilave ishin shpenzuar 8,517,079€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtjen verore dhe dimërore, shërbime kontraktuese, shpenzime të qirasë dhe shërbime tjera operative. Ne kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 832,116€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3– Themelimi i Njësive për Zbatimin e projekteve (NjZP) pa propozimin paraprak nga Ministri i Financave

Gjetja

Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore 06/L-133 neni 20 paragrafi 1, Me qëllim të zbatimit dhe mbikëqyrjes së projekteve të financuara nga huamarrja dhe projekteve me interes për Republikën e Kosovës, me propozimin e Ministrit të Financave, mund të kompensohen ekspertët përkatës për mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve të tilla, sipas aktit nënligjor[7] të dalur nga Ligji 03/L-175 për Borxhet Publike.

Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe shqyrtimit të mostrave ne kemi identifikuar se, në MI janë të themeluara disa Njësi për Zbatimin e Projekteve të financuara nga huamarrja, prej të cilave ne i kemi identifikuar gjashtë prej tyre. Këto NjZP, janë të themeluara me vendim të Ministrit të Infrastrukturës pa miratimin paraprak të Ministrit të Financave e cila kërkohet sipas ligjit.

Menaxhmenti i MI nuk ishte në gjendje të ofroj shpjegimet e duhura për anashkalimin e kërkesave ligjore dhe arsyet për themelimin e këtyre NjZP-ve.

Ndikimi

Themelimi i këtyre njësive duke mos iu përmbajtur kërkesave rregullative mund të ndikoj në shpenzime të parregullta të buxhetit si dhe mangësi në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të siguroj se janë marrë masa për qartësimin e ligjshmërisë së këtyre njësive, të rishikohen vendimet për themelimin e tyre si dhe të ndërmerren veprimet konkrete, duke shtuar kontrollin dhe ngritur nivelin e llogaridhënies në pajtim me kërkesat rregullative.

[7] Rregullore 01/2016 për administrimin e fondeve të huamarrjes, me plotësim ndryshimet 03/2017 dhe 05/2017.

Çështja A4- Realizimi i pagesave nga fondi i huamarrjes jo në pajtueshmëri me marrëveshjen

Gjetja

Forma dhe kategoritë të cilat do të financohen nga huamarrja përcaktohen në marrëveshjet përkatëse të huamarrjes për projektet e financuara. Këto marrëveshje përcaktojnë kategoritë e zërave që do të financohen me hua. Duke iu referuar Ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2019 06/L-133 neni 20 mbikëqyrja e zbatimit të projekteve të financuara nga huamarrjet bëhet ashtu siç është paraparë në marrëveshjen e huamarrjes. Si rrjedhojë, ndarjet buxhetore për burimin e huamarrjes do të duhet të jenë të destinuara për zbatimin e këtyre projekteve dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në marrëveshjen e huas.

Sipas Marrëveshjeve për hua, kategoria e planifikuar për financim nga huaja janë vetëm për Punë civile[8] dhe nuk parashohin financimin e kategorive tjera operacionale.

Në programin buxhetor '43000 – Njësia për Implementimin e Projekteve' sipas Ligjit për ndarjet buxhetore ishin ndarë mjete në vlerë prej 300,000€ për financim nga huamarrjet, ndërsa janë shpenzuar 269,507€ deri në fund të vitit.

Nga testimet e mostrave kemi identifikuar shtatë pagesa (në vlerë totale prej 30,305€) të cilat ishin ekzekutuar në SIMFK nga burimet e huamarrjes, por që do të duhej të ekzekutoheshin nga Granti Qeveritar. Pagesat, janë ekzekutuar për kompensimin e personelit të angazhuar për kryerje të shërbimeve në NjZP Kijevë-Zahaq (3 pagesa), NjZP Rrugët Rajonale (3 pagesa) dhe NjZP Prishtinë – Gjlan Dheu i Bardhë (një pagesë).

Lidhur me këtë çështje, kishte sugjerime edhe nga Thesari për mos realizimin e mjeteve nga ky program. Prandaj, këto mjete, do t'i mbesin barrë Buxhetit të Kosovës, pasi që, këto pagesa nuk kanë të bëjnë me këtë projekt dhe nuk do të mund të disbursohen nga huadhënësi, duke qenë si pagesa jo në pajtueshmëri me kushtet e marrëveshjes së huadhënësit.

[8] Duke iu referuar Ligjit 06/L-063 për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e Autostradës Kijevë-Zahaq dhe Ligjit 05/L-097 për Ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Rehabilitimin e Rrugëve Rajonale termi 'punë civile' përdoret për punët ndërtimore të cilat ekzekutohen nga kategoria e Investimeve Kapitale.

Projekti 'Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës Magjistrale Prishtinë-Mitrovicë' është projekti i vetëm që sipas marrëveshjes për hua kishte të planifikuar financimin e shërbimeve këshillëdhënëse (në kuadër të shpenzimeve operacionale) dhe një pjesë e mjeteve të buxhetuara në këtë program ishin shpenzuar sipas destinimit për këtë projekt.

Me gjithë përpjekjet tona për sqarimet e nevojshme me SP rreth funksionimit të këtyre njësive, ne nuk kemi marrë përgjigjet e nevojshme.

Ndikimi Një situatë e tillë, ka ndikuar që ekzekutimi i pagesave është bërë jo në pajtueshmëri me fondin e huamarrjes, fonde të cilat edhe më tej do të mbesin pa u disbursuar nga huadhënësi. Prandaj, mjetet e shpenzuara do të jenë barrë e buxhetit dhe si shpenzime të pa planifikuara.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj një rishikim të sistemit të kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin dhe procesimin e pagesave për NjZP-të, për të siguruar besueshmëri lidhur me shfrytëzimin e burimeve buxhetore, duke përfshirë edhe ato nga fondi i huamarrjes.

Çështja A5-Angazhimi i zyrtarëve në NjZP pa aprovimin e huadhënësit

Gjetja

Duke iu referuar Marrëveshjes[9] për hua për projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë seksioni 3.04, Marrëveshjes për hua për rehabilitimin e Rrugëve Rajonale dhe Marrëveshjes për projektin e autostradës Kijevë-Zahaq paragrafët 3.02, personeli i angazhuar në NjZP duhet të jetë i kualifikuar sipas termave të referencës të pranueshme për huadhënësin. Rrjedhimisht, siç është e rregulluar me aktet nënligjore[10] kontrata do t'i jepet stafit të Njësisë vetëm pasi të ketë marrë miratimin përfundimtar nga kreditori.

Për projektet e përmendura, ne kemi identifikuar tre raste të personelit të angazhuar tek këto NjZP pa marrë aprovimin nga huadhënësi. Personeli ishte angazhuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm. Angazhimet ishin te Njësia Prishtinë-Mitrovicë, një zyrtar ekspert i financave; njësia për Rrugët Rajonale, një zyrtarë ekspert për buxhet dhe financa; dhe Njësia Kijevë-Zahaq, një zyrtar ekspert i prokurimit.

Ndonëse MI nuk ka dhënë sqarimet rreth funksionimit të këtyre njësive, sipas themelimit dhe funksionimit të NjZP-ve, duket se MI nuk ka përfillur kërkesat e huadhënësit sipas marrëveshjes së ratifikuar.

Ndikimi

Angazhimi i personelit tek NjZP-të pa zbatimin e termave të referencës sipas marrëveshjes së huadhënësit, ndikon në krijimin e shpenzimeve të pa rregullta.

Rekomandimi A5

Ministri duhet të siguroj se është kërkuar llogaridhënie duke identifikuar rastet e tilla dhe se janë marrë masa në vënien e kontrollit, duke rishikuar përbërjen e anëtarëve në NjZP, të cilat duhet të jenë në harmoni me kërkesat sipas marrëveshjeve të aprovuara nga huadhënësi dhe të parandalojnë angazhimet e tilla në të ardhmen.

[9] Ligji nr 04/L-256, ratifikimi i marrëveshjes për hua për projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

[10] Neni 7 paragrafi 7 e rregullore 01/2016 e plotësuar 05/2017.

Çështja A6- Avanset e mbyllura pas afatit të lejuar ligjor

Gjetja

Sipas UA 2004/07 për udhëtime zyrtare neni 8 thekson se kërkesa për kompensim dhe mëditje së bashku me dëshmitë për shpenzimet financiare i dorëzohet shërbimit për buxhet dhe financa brenda 15 ditë pune nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar.

Në këtë fushë janë testuar katër mostra në vlerë totale prej 8,086€ nga avanset e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, të cilat kanë rezultuar me mbylljen e tyre pas afateve ligjore. Fjala është për pagesat në shumat: 905€ (20 ditë); 2,819€ (32 ditë), 2,806€ (4 ditë) dhe 1,556€ (21 ditë).

Shkak për këto vonesa është neglizhenca e shfrytëzuesve të avanseve për t'i kryer detyrimet e tyre me kohë, por edhe e zyrtarëve të financave për të zbatuar përgjegjësitë e tyre ndaj menaxhimit të këtyre fondeve.

Ndikimi

Mos efikasiteti i kontrolleve me rastin e mbylljes së avanseve, mund të ndikoj në moskthimin e mjeteve dhe shfrytëzimin e tyre në mënyrë të pa autorizuar.

Rekomandimi A6

Ministri të ndërmerr masa në shtimin e kontrollit në administratë, në mënyrë që të njoftohen zyrtarët përkatës rreth kryerjes së obligimit për mbylljen e avanseve me kohë, ashtu që të rritet përgjegjësia e zyrtarëve të cilët shfrytëzojnë avanse për udhëtime zyrtare.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,878,814€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 1,502,676€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me transportin humanitar rrugor dhe transportin hekurudhor sipas marrëveshjes me Trainkos. Ne kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 352,504€ si dhe një (1) mostër për teste të pajtueshmërisë si procedura e vetme e ekzekutuar gjatë vitit.

Nuk kemi identifikuar parregullsi në këtë fushë.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 288,854,447€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 185,157,470€ apo 64%. Ato kanë të bëjnë me ndërtime të rrugëve, shtresime të rrugëve, bashkëfinancime të projekteve bazuar në Memorandumet me Komunat, mirëmbajtja e rrugëve, etj.

Faktorë që kanë ndikuar në nivelin e ulët të shpenzimeve janë ngecjet në ekzekutimin e projekteve të planifikuara nga klauzola e investimeve (71,500,000€) të cilat nuk ishin realizuar fare, si dhe vonesa në ekzekutimin e projekteve të financuara nga huamarrjet. Ngecje kishte në projekte si "Rehabilitimi i rrugës M2 Prishtinë-Mitrovicë" dhe "Zgjerimi i Rrugës Liqeni i Badovcit-Mramor-Grashticë".

Kemi testuar 102 mostra për teste substanciale në vlerë 89,274,826€, si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë, ndërsa për një lëndë kemi pranuar dëshmitë se lënda origjinale është marrë për hetime të mëtejshme nga organet e hetuesisë. Po ashtu, procedurat që lidhen me OE-të e kontraktuar lidhur me autostradën Prishtinë-Hani i Elezit janë marrë për hetime nga organet e hetuesisë. Pagesat lidhur me këtë ne i kemi përfshirë në testimet substanciale me ç'rast i kemi trajtuar nga aspekti i pajtueshmërisë me kontratën dhe prezantimin e tyre në librat kontabël.

Sipas ministrisë, gjatë vitit ka pasur realizim të ulët të punimeve dhe pagesave për arsye se, për këto projekte nuk është rregulluar çështja e shpronësimit. Rrjedhimisht, si rezultat i vonesave në kryerjen e obligimeve ndaj pronarëve të pronave janë paraqitur pengesa nga pronarët në kryerjen e punëve.

Çështja A7-Ndryshimi i projektit dhe pranimi i punëve jo sipas specifikacionit teknik

Gjetja

Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.20 përcakton se "menaxherët e Projektit duhet të sigurojnë që operatori ekonomik i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës". Po ashtu neni 61.21 "Ndryshimi i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës dhe në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit".

Te projekti "Ndërtimi i rrugës Bardh i Madh – Lismir, Fushë Kosovë, L=3,521m" në vlerë 475,904€, me datë 03.03.2020, ne kemi bërë ekzaminimin fizik, me ç`rast kemi identifikuar se për pozicione të cilat ishin lëshuar në situacionin financiar për pagesë si të përfunduara nga operatori ekonomik dhe të verifikuara nga menaxheri i projektit, disa nga to nuk ishin kryer. Po ashtu, kishte ndryshim në disa pozicione të projektit apo mosrealizim të pozicioneve për të cilën nuk ishin marrë aprovime nga njësia kërkuese.

Pozicionet për punët e pranuara, por të pa përfunduara (sipas ekzaminimit), ishin si në vijim:

- Punët tokësore Pozicioni 1.3.8.1 Humusim i skarpateve të rrugës me trashësi t=15cm, përfshihen edhe kyqjet, ishte paguar vlera 5,519€, ndërsa nuk ishte punuar fare ky pozicion;
- Punët tokësore Pozicioni 1.3.1 Gërmimi i dheut, vlera 30,266€, ishte kryer pjesërisht dhe jo sipas projektit;
- Sinjalizimi Horizontal (Termoplastikë) Pozicioni 1.1 – 1.6, furnizimi dhe realizimi i vijës ndarëse të shiritave të qarkullimit, vlera e paguar 19,522€, ndërsa është bërë furnizim me ngjyrë të thjeshtë (nuk ishte ngjyrë termoplastikë);
- Sinjalizimi Vertikal Pozicioni 2.1-2.4, furnizimi dhe vendosja e shenjave të udhëkryqeve, shkallët e lajmërimit dhe dimensionim sipas standardeve, vlera e paguar 1,760€, sinjalizimet ishin fiksuar shumë dobët (shumica e tyre me dorë mund të lëvizeshin nga vendi, dhe dy prej tyre ishin rrëzuar).

Po ashtu, në dosjen e projektit kemi vërejtur se me vendimin nr. 10991 të datës 11.10.2019, Sekretari kishte emëruar komisionin për pranimin teknik dhe llogarinë përfundimtare të punëve të kryera në "Bardh i Madh, Lismir, Fushë Kosovë, L=3,521 m". Ky komision me datë 31.10.2019 kishte dërguar raportin tek menaxhmenti i ministrisë për pranimin teknik për punët e kryera sipas kontratës, dhe ka theksuar se punimet nuk janë kryer sipas projektit kryesor të hartuar, se me pëlqimin e menaxherit të kontratës janë bërë ndryshime pa aprovime paraprake të Autoritetit Kontraktues. Në fund, nga komisioni është konkluduar se nuk pranohen punët e kryera, ka shkelje të kushteve të kontratës dhe mos zbatim të projektit, dhe jeta e përdorimit nuk mund të përcaktohet për këtë projekt. Gjatë ekzaminimit tonë të punëve, ishin prezent edhe këta anëtarë të komisionit.

Këtë raport menaxheri i kontratës e kishte refuzuar, dhe kishte kërkuar nga sekretari të ndryshohet komisioni i pranimit teknik. Ndërkohë, menaxheri i kontratës kishte bërë disa ndryshime në situacionin përfundimtar për pagesë, duke ndryshuar disa pozicione të cilat i kishte aprovuar më parë tek pagesat[11].

Sekretari me datë 06.12.2019 me vendim kishte ndryshuar anëtarët e komisionit, dhe kishte kërkuar që të bëhet një vlerësim i ri për pranimin teknik.

Komisioni i ndryshuar, me datën 23.12.2019 kishte hartuar raportin për pranim teknik të projektit. Konkluzioni i komisionit ishte se pranohen punimet e kryera sipas kontratës, pasi që vërehet se punët janë kryer sipas kualitetit të kërkuar. Mirëpo, duhet të theksohet se në këtë periudhë, menaxheri i kontratës kishte ndryshuar situacionin final në disa pozicione nga ai që kishte pasur në dispozicion komisioni i parë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheri i projektit kishte nënshkruar raportet që punët janë përfunduar sipas kushteve të kontratës, përderisa ato nuk ishin kryer. Po ashtu, edhe si rezultat i neglizhencës së menaxhmentit për të pranuar dhe analizuar raportin e pranuar nga komisioni i parë, dhe marrjen e veprimeve të duhura për këtë projekt.

11 Tek pagesa në vlerë 236,815€, (çertifikata për pagesë vlerë 236,815€ e dt. 15.07.2019) pozicionet e paguara ishin: Pozicioni 3-Lëshesat Pllakore 400X350x800, punët e betonit dhe armatura, vlera 12,300€; dhe Pozicioni 4-Lëshesa Pllakore 200X250X800, punët e betonit dhe armatura, vlera 5,128€; dhe Tek pagesa në vlerë 20,675€, (çertifikata për pagesë dt. 20.12.2019, situacioni i fundit) Pozicionet e paguara/ndryshuara ishin: pozicioni 3.Lëshesat Pllakore 400X350x800, punët e betonit dhe armatura, vlera e paguar 1,019€, dhe pozicioni 4.Lëshesa Pllakore 200X250X800, punët e betonit dhe armatura, vlera e paguar 781€.

Ndikimi Mos realizimi i projektit sipas paramasave të kontratës së nënshkruar dhe nënshkrimi i raporteve të pranimit nga menaxheri kontratës, për punë të cilat nuk janë realizuar sipas kontratës, ndikon në rritjen e rrezikut të sigurisë së qarkullimit në komunikacion, si dhe dëmtimin e buxhetit të ministrisë. Në aspektin financiar tek pozicionet e lartë përmendura, nuk është e sigurt nëse është arrit vlera për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të siguroj mbikqyrje efektive të projekteve, në mënyrë që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim të plotë me kushtet e kontratës dhe pagesat të kryhen vetëm për punët e ekzekutuara. Po ashtu, të siguroj se menaxherët e kontratave për çdo ndryshim në kushte të kontratës gjatë zbatimit të projektit, bëhet vetëm pas aprovimeve paraprake të marra nga njësia kërkuese dhe ZKA.

Çështja A8- Ndryshime në pozicionet e kontratës pa aprovime paraprake

Gjetja Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.6 "Pasi të jetë shpërndarë kontrata, menaxhimi i kontratës, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë, do të kalojë nga Departamenti i prokurimit te Menaxheri i Projektit", neni 61.20 përcakton se "menaxherët e Projektit duhet të sigurojnë që operatori ekonomik i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës", neni 61.21 "Ndryshimi i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit".

Te projekti "Shtresimi me asfalt në rrugën Hajkobillë-Zajqevc-Tuxhec L=12550M" në vlerë 1,049,441€, kemi vërejtur se kishte ndryshime të sasive të realizuara në 13 pozicione duke rritur sasinë e kontraktuar deri 25% por pa ndryshuar çmimin e kontratës. Ndërsa, disa pozicione nuk ishin realizuar fare.

Po ashtu, projekti ka dështuar të realizohet sipas paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar në disa pozicione. Vlera e planifikuar e këtyre pozicioneve[12] ishte 31,858€. Në këto pozicione janë kryer punë në vlerë prej vetëm prej 660€.

[12] Pozicionet: Punët e Betonit, nga pozicioni 4.1 – 4.5 Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve 18x24 c 30/ 37.1 M100, 4.5 -4.9, pozicioni Gërmimi i dheut dhe makinë për hapjen e vrimave për 30 pilota me diametër D= 50 cm me thellësi H=8.0m. dhe 4.10-4.13.

Për këto ndryshime nuk ishte marrë aprovimi paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA). Sipas menaxherit të kontratës këto pozicione nuk janë realizuar sepse ai e kishte vlerësuar se nuk ka pasur nevojë dhe mjetet janë paguar për realizim të punëve shtesë për disa pozicione tjera. Për këtë çështje, ne kemi kërkuar shpjegime më të hollësishme, por nga menaxheri kontratës nuk kemi marrë ndonjë përgjigje.

Ndikimi Ndryshimi i paramasës së projektuar dhe të kontraktuar pa aprovime paraprake nga njësia kërkuese dhe ZKA-ja, mund të ndikojnë që punët në realizimin e kontratës të mos jenë konform kërkesave të projektit dhe të mos merret vlera për para.

Rekomandimi A8 Ministri duhet të siguroj se çdo ndryshim në kushte të kontratës gjatë zbatimit të projektit bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit, aprovimeve paraprake të marra nga ZKA dhe njësia kërkuese.

Çështja A9- Hyrje në obligime kontraktuese përtej ndarjeve të aprovuara buxhetore

Gjetja

Sipas ligjit për buxhet 2019, nr. 06/L-166, neni 12, pika 6 përcakton se nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga organizatat buxhetore vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2019 dhe për dy (2) vitet në vijim. Po ashtu, bazuar në Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, neni 8.1.1 përcakton se AK do të inicioj një aktivitet të prokurimit, vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave, pse saktësisht nevojitet prokurimi, dhe neni 8.2, ZKF do të siguroj që fondet janë në disponueshmëri për prokurimin në fjalë.

Ne kemi identifikuar tre (3) raste që MI kishte nënshkruar kontratat për disa projekte me vlerë më të madhe se buxheti i planifikuar sipas ndarjeve buxhetore.

- Për projektin "Ndërtimi i rrugës Lubozhë-Lugu i butë"[13], në vitin 2019 ministria ka nënshkruar kontratë me vlerë 3,133,834€, dhe realizimi i punëve ishte caktuar të kryhet për 355 ditë pune, ndërsa ndarja buxhetore e përcaktuar në tabelën e projekteve kapitale ishte parashikuar vetëm për vitin 2019 në vlerë 150,000€ dhe jo për vitin tjetër.

- Për projektin "Zgjerimi i rrugës nacionale N9.1 segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00" (me numër 15658). Ndarja buxhetore bazuar në tabelën 3.2 të Ligjit të buxhetit për këtë projekt ishte 27,448,597€. Në muajin mars të 2019 ishin lidhur tre kontrata në vlerë 12,873,225€. Rjedhimisht, mjete të lira për këtë projekt pas nënshkrimit të kontratës ishin 14,575,372€. Po ashtu, në korrik 2019, MI kishte nënshkruar tre kontrata tjera (të ndara në tre lote) në vlerë 21,022,555€. Me këtë rast, MI kishte hyrë në obligime kontraktuese më shumë se ndarjet buxhetore në dispozicion për 6,447,183€.

- Për projektin "Rehabilitimi i Rrugës Regjionale r 115 Gërlicë e Epërme-Shtërpcë-Brezovicë dhe rruga r 210 Brezovicë - Qendra e Skijimit", në vitin 2019 Ministria kishte nënshkruar kontrata me vlerë 3,240,609€, ndërsa ndarja buxhetore e paraparë për tre vite në tabelën 3.2 të projekteve kapitale në Ligjin e Buxhetit ishte 1,300,000€.

Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, ku përcaktohet vlera e parashikuar e projektit, nuk ishin bërë në pajtim me ligjin e buxhetit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti ka parashikuar se mund të ndodhin ndryshime tek rritjet buxhetore për këto projekte.

[13] Projekti numër 18393.

Ndikimi Hyrja në obligime kontraktuese në vlera më të larta se ndarjet buxhetore, pa sigurimin e fondeve të duhura, mund të ndikojnë në dështimin e kontratave dhe krijimin e obligimeve të cilat do të jenë ngarkesë për buxhetin e viteve vijuese. Kjo gjithashtu rritë rrezikun që ministria të bëhet subjekt i kontesteve gjyqësore, të cilat mund të përfundojnë me kosto shtesë të kontratave.

Rekomandimi A9 Ministri duhet të siguroj se obligimet kontraktuese krijohen vetëm brenda kufijve të ndarjeve vjetore të buxhetit. Në rastet kur kontratat janë shumëvjeçare, kjo të parashihet edhe me kornizën afatmesme të shpenzimeve, dhe zotimi i fondeve të bëhet deri në shumat që planifikohet se do të jetë progresi i kontratave.

Çështja B2- Pranimi teknik i punëve dhe projekteve nga komisionet me përbërje jo kompetente

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) Nr.2008/3 të MI, nenit 2 pika 3, është përcaktuar se anëtarët e komisionit të ekspertëve për mbikëqyrje të punëve, pranim teknik dhe kolaudimin e punëve të kryera duhet të jenë persona me kualifikim dhe njohuri të specializuara në sektorin e infrastrukturës rrugore nga lëmi i ndërtimtarisë, sigurisë në komunikacionin rrugorë, e të ngjashëm. Po ashtu, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të nënshkruajë një kontratë, por është i ndaluar që të nënshkruajë pranimin e mallrave, artikujve të instaluar, përfundimin e një projekti, dorëzimin në faza, ose pagesën e një fature.

Ne kemi identifikuar se në tre raste përbërja e komisioneve për pranimin e punëve nuk ishte nga anëtarët me kompetencë dhe njohuritë nga fusha e kërkuar. Në këto raste në përbërje të komisioneve kishte dy inxhinierë dhe një anëtarë tjetër të fushave jo profesionale dhe pozitës që nuk lejohet, si ekonomist dhe zyrtar nga zyra e prokurimit:

- Projekti "Shtresësimi me Asfalt në rrugën Hajkobillë–Zajqevc-Tuxhevc" është caktuar anëtar zyrtari i prokurimit;
- Projekti "Ndërtimi i rrugës Gjeravicë, segmenti Junik-Lugu i Gjatë" është caktuar anëtar zyrtari i prokurimit; dhe
- Projekti "Ri-asfaltimi i rrugës Rajonale R220, Segmenti Bukosh-Prilluzhë" është caktuar anëtar ekonomist.

Këto kanë ndodhur si rezultat i mos analizimit të mirë të kërkesave ligjore, UA të MI-së apo neglizhimit të tyre.

Ndikimi Emërimi i zyrtarëve jo kompetent në komisionet e pranimit teknik dhe vlerësimit të gjendjes së ndërtimit, rritë rrezikun e pranimit të projekteve jo në pajtueshmëri me standardet dhe cilësinë e kërkuar. Po ashtu, kjo nuk është në pajtim me parimet e ndarjes së detyrave.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar në pajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.

Çështja B3-Mos pjesëmarrja e zyrtarëve të MI-së në komisionet për hapje dhe vlerësim të ofertave në projektet për bashkëfinancim me komunat

Gjetja

Sipas memorandumeve të bashkëfinancimit me komuna, neni 4 pika 4, përcaktohet se në hapje dhe vlerësim të tenderit duhet të jetë një anëtar nga MI, që të siguroj se ofertuesi fitues ka dorëzuar tërë dokumentacionin e kërkuar dhe se procesi i përzgjedhjes është bërë sipas legjislacionit në fuqi.

Në tre raste kemi identifikuar se zyrtarët e MI-së nuk ishin caktur si pjesë përbërëse e komisioneve të vlerësimit të ofertave në proceset e prokurimit të zhvilluara nga komunat për projektet:

- Financimi i projektit në Komunën e Klinës, "Asfaltimi i rrugës në Jashanicë të Klinës-faza 2";
- Financimi i projekteve në Komunën e Istogut, "Ndërtimi i qendrës së Istogut, rruga "Ibrahim Rugova", "Fadil Ferati" dhe "UÇK"-së; dhe
- Financimi i projektit në Komunën e Rahovecit, "Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci deri në Xërxë".

Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës së MI për të emëruar zyrtarët sipas kërkesës së memorandumeve.

Ndikimi

Mos pjesëmarrja e zyrtarëve të ministrisë në komisionet për hapje dhe vlerësimin e ofertave të zhvilluara nga komunat, mund të rezultojë në përzgjedhjen e operatorëve të pa përgjegjshëm dhe mos informimin e ministrisë për dinamikën e projekteve.

Rekomandimi B3

Ministri duhet sigurohet se pjesë e komisioneve në procesin hapjes dhe vlerësimit të ofertave, duhet të jenë të përfshirë edhe zyrtarë të ministrisë, apo siç parashihet me marrëveshjet përkatëse, për t'u siguruar se proceset e prokurimit zhvillohen në kuadër të një transparence të plotë dhe në pajtim me rregulloret, si dhe të informohet me dinamikën e projekteve.

Çështja A10 - Dobësitë në Çertifikimin e lëndëve

Gjetja

Sipas LMFPP 03 L-048, dhe plotësim ndryshimet, neni 14.4 Zyrtari Çertifikues është përgjegjës që të siguroj zbatimin e një kontrate publike para autorizimit të pagesës si dhe e njëjta është në pajtim me aktet nënligjore: a) të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës, b) të sigurojë që shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF.

Ne kemi testuar 10 pagesa[14] dhe kemi identifikuar se zyrtari çertifikues në momentin e çertifikimit nuk kishte në dosje të pagesës specifikacionin teknik, respektivisht çmimet e kontraktuara si dhe situacionet e ndara që pasqyrojnë punën e kryera për faturat përkatëse. Në dosjen e pagesës ishin vetëm dy fletët e para të kontratës. Pagesat e çertifikuara si dëshmi kishin situacionet e pranuara nga menaxherët të cilat pasqyrojnë punën totale (në mënyrë kumulative) nga lidhja e kontratës apo nga fillimi i punëve deri në datën e pagesës, e jo situacionin/punën e cila ndërlidhet me pagesën aktuale. Duke pas parasysh këtë, një përcjellje e punëve të kryera bazuar në faturë duke e ndërlidhur me çertifikatën e aprovuar për pagesë dhe kontratën ka qenë e pamundur.

Ne këto mostra i kemi testuar në bashkëpunim me menaxherat e kontratave përkatëse, duke kërkuar librat ndërtimor, në bazë të cilave kemi shikuar sasinë e punëve të realizuara për pagesë. Nga verifikimet tona në disa raste kemi identifikuar diferenca, pra faturim dhe pagesë më shumë se sa punët e përfunduara sipas librit ndërtimor; si: projekti 13000 Mirëmbajtja verore e rrugëve regjionale dhe rajonale 2018/2019 regjioni Gjilani 2 situacioni i gjashtë diferenca 992€.

Pagesa e obligimeve sipas dy faturave të datës 31.03.2019 lidhur me karburante në vlerë prej 12,282€ ishte ekzekutuar duke i lënë dëshmi mbështetëse kontratën paraprake (05.11.2015) e jo atë aktuale (11.02.2019).

Shkak për këtë ishte se zyrtarët e ministrisë (menaxherët e projekteve) e kishin konsideruar si një praktikë të mirë, formën e çertifikatave të përdorura deri më tani (kumulative).

[14] (1) 682,160€, datë 08.04.2019; (2) 1,063,868€ datë 25.07.2019; (3) 649,597€ datë 25.07.2019; (4) 1,513,789€ datë 19.06.2019; (5) 100,525 € datë 29.02.2019; (6) 67,030€ datë 17.04.2019, (7) 90,068€ datë 30.04.2019; (8) 88,992€ datë 12.03.2019 nga investimet kapitale dhe (9) dy pagesa nga mallra dhe shërbime në vlerë 127,166€ dhe 281,593€ datë 08.03.2019.

Ndikimi Çertifikimi i pagesave në mungesë të specifikacioneve teknike që janë pjesë e kontratës dhe situacioneve të ndara për çdo faturë ndikon në rritjen e rrezikut që të çertifikohen pagesa jo në harmoni me sasitë dhe çmimet e kontraktuara dhe kjo mund të i shkaktoj humbje financiare Ministrisë. Po ashtu, neglizhenca e zyrtarëve gjatë procesimit të lëndës për pagesë rritë rrezikun e autorizimit të pagesave të parregullta dhe jo në përputhje me marrëveshjet kontraktuale.

Rekomandimi A10 Ministri duhet të siguroj se zyrtari certifikues, gjatë procesimit të pagesave të sigurohet se në dosje është e bashkangjitur pjesa financiare e kontratës dhe çertifikimi i pagesës do të bëhet vetëm në bazë të situacioneve të cilat paraqesin punët në mënyrë specifike që ndërlidhen me faturë, dhe të dëshmuara me dokumentacionin relevant.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,571,666,591€, pasurive jokapitale 160,175€, dhe e stoqeve 100,433€. Ne kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 87,057,205€, si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C2- Vonesë në procesin e inventarizimit për vitin 2019

Gjetja

Sipas Rregullores nr 02/2013 Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në OB nenit 19 pika 4.3, komisioni për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare ka përgjegjësi të bëj krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, dhe pika 4.7 hartimin e raportit në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare.

Komisioni për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në MI kishte hartuar raportin më datë 02.03.2020, ndërkohë që vendimi për caktimin e komisionit për inventarizimin e pasurisë ishte nxjerrë më 13.12.2019. Ky proces ishte me vonesë duke pas parasysh se raporti ishte hartuar pas dorëzimit të PVF-ve finale. Raporti është gjithëpërfshirës dhe krahas përshkrimit të procesit të ndjekur nga komisioni përmban listën e pasurive të dëmtuara. Raporti nuk ka specifikuar vërejtje sa i përket harmonizimit të regjistrave apo identifikimit të diferencave.

Sipas raportit të komisionit, koha e nxjerrjes së vendimit për caktimin e komisionit dhe mungesa e zyrtarëve kishin ndikuar përfundimin e procesit.

Ndikimi

Vonesat në procesin e inventarizimit ndikojnë në harmonizimin e regjistrave me gjendjen e inventarizuar, çka edhe ndikon në vërtetimin e saktësisë dhe gjendjes së pasurisë në Pasqyra Financiare.

Rekomandimi C2

Ministri duhet të siguroj se janë evituar shkaqet që ndikojnë në vonesa dhe mangësi në procesin e inventarizimit të pasurive që do të mundësonin raportimin e drejtë të vlerës financiare të pasurive sipas kërkesave ligjore.

Çështja A11 – Mangësi në azhurnimin e regjistrave të pasurisë

Gjetja Neni 6.1 i Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu sipas nenit 6.3 Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Fatura në vlerë prej 83,409€ përmbante 9 njësi në vlerë të përbashkët 29,166€ të cilat i takonin klasifikimit në kapitale për nga vlera. Ato ishin regjistruar në regjistrin e-pasuria si kapitale, por jo në SIMFK sipas kërkesave ligjore.

Kjo gjendje është e ndikuar nga një planifikim jo gjithëpërfshirës buxhetor i cili do të ishte i bazuar në nevojat e parashikuara të organizatës, si dhe mungesa e kompetencave lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi Mangësitë e identifikuara në regjistrat e pasurive tregojnë një nënvlerësim të pasurive dhe prezantim jo të drejtë në vlerën e pasurive në pasqyra financiare.

Rekomandimi A11 Ministri duhet të siguroj se ekzistojnë kontrolle funksionale të cilat sigurojnë që regjistri i pasurive azhurnohet sipas klasifikimit të duhur duke reflektuar vlerën e saktë të prezantuar. Po ashtu, të sigurohet mbështetje e duhur në trajnimin e personelit të angazhuar në menaxhimin e pasurisë.

2.3 Të arkëtueshmet

MI në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,269,824€. Kjo vlerë përbehet nga obligimet e pa arkëtuara për më shumë se 30 ditë nga faturimet për pompa të karburanteve, transport të jashtëzakonshëm, qiraja, hyrje-daljet e objekteve afariste, vendosje e infrastrukturës nëntokësore dhe të tjera.

Ministria nuk ka ndonjë procedurë apo udhëzim se si do të menaxhoj dhe trajtoj Llogaritë e arkëtueshme. Po ashtu, nuk ka as ndonjë softuer për regjistrimin dhe menaxhimin e tyre. Të arkëtueshmet regjistrohen në një bazë excel të përgatitur nga zyrtarët që i regjistrojnë të hyrat i cili nuk jep informata të mjaftueshme për marrjen e vendimeve dhe menaxhimin e tyre.

Çështja A12-Trajtimi i llogarive të arkëtueshme dhe mos ndërmarja e veprimeve për inkasim

Gjetja

Sipas UA 2/2014, neni 4 përcakton tarifat sipas destinimit që duhen paguhen për shfrytëzimin e tokës për vendosjen e instalimeve dhe kyçjen në rrugë. Po ashtu, sipas marrëveshjeve të nënshkruara në mes MI dhe shfrytëzuesve të pronës publike përcaktohen afatet e inkasimit të arkëtueshmeve.

Nga pesë (5) mostrat e testuara në vlerë prej 6,382€ kemi identifikuar se MI nuk kishte ndërmarr ndonjë veprim për të zvogëluar llogaritë e arkëtueshme. MI vetëm ka dërguar faturat dhe nuk ka ndërmarrë veprime për arkëtimin e të hyrave. Një nga pesë rastet e testuara, nuk ka paguar qiranë për shfrytëzimin e pronës publike nga viti 2016, kurse katër (4) rastet tjera, pagesën do të duhej ta kryenin në vitin 2019.

Shkak i kësaj është se MI nuk ka ndonjë procedurë apo udhëzim të brendshëm për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e këtyre llogarive.

Ndikimi

Mos ndërmarrja e masave konkrete për arkëtimin e borxheve, mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të buxhetit për shkak të mos realizimit të të hyrave.

Rekomandimi A12

Ministri duhet të ndërmerr veprime për të identifikuar arsyet e vonesave në inkasimin e këtyre pagesave dhe dhe të krijojë mekanizma efektiv për inkasimin e borxheve nga debitorët.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Sipas të dhënave të prezantuara nga ministria, gjendja e detyrimeve në fund të vitit 2019 ishte 23,050,576€. Këto detyrime janë bartur për pagesë në vitin 2020.

Çështja C3- Raportim jo i drejtë i obligimeve në Pasqyra Financiare

Gjetja Sipas Rregullores MF- Nr. 01/2017 për PVF, neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e pa paguara, pika 3. Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Nga testimi i sistemit të menaxhimit dhe raportimit të obligimeve ne kemi identifikuar një faturë e cila ishte paguar pjesërisht ndërkohë që nuk ishte raportuar pjesa e mbetur e obligimit në vlerë prej 894,983€. Fatura me numër 10/01-2019 për pagesë ishte në vlerë 4,773,513€, mirëpo MI në mungesë të mjeteve kishte paguar vetëm pjesërisht obligimin. Kemi vërejtur se ky obligim nuk ishte raportuar në PVF. Po ashtu, nuk është bërë specifikimi i drejtë sipas ditëve të obligimit të mbetur (më pak apo më shumë se 30 ditë).

Këto parregullsi vijnë kryesisht për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme të cilat do të duhej të ishin vënë në funksion të një menaxhimi të drejtë të obligimeve.

Ndikimi Dobësitë e tilla ngrisin dyshime për saktësinë e obligimeve të prezantuara në Pasqyra Financiare. Po ashtu, duke pas parasysh vonesat në obligime Ministria mund të jetë subjekt i ekzekutimit direkt të pagesave nga MF dhe vendimeve gjyqësore.

Rekomandimi C3 Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve.

Çështja A13-Vonesa në kryerjen e obligimeve

Gjetja

Sipas nenit 39 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, organizatat buxhetore duhet çdo faturë të vlefshme ta paguajnë brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës.

- Nga testimi i pagesave në kategorinë e investimeve kapitale në 6 raste[15], dhe në mallra dhe shërbime 4 raste[16], faturat apo obligimet ndaj furnitorëve në vlerë totale 431,077€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin nga 11 ditë deri në 5 muaj.

- Po ashtu, faturat apo obligimet ndaj furnitorit Bechtel Enka në vlerë totale 49,888,561€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Faturat ishin nga viti 2018. Qeveria me vendimin nr. 01/50 të datës 05.06.2018, kishte aprovuar kërkesën e konzorciumit Bechtel&Enka për të ndarë mjete me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për vazhdimin e ndërtimit të rrugës nacionale R6, "Arbër Xhafer", Prishitnë - Hani i Elezit. Bazuar në Marrëveshjen nr. 02/8457 e nënshkruar në mes të MI dhe Konzorciumit në fjalë me datë 05.09.2018, përfshihet pagesa për zgjatjen e afatit në vlerë 53,100,000€. Sipas kësaj marrëveshje pagesa duhet të bëhet në 12 këste (4,425,000€ secila), dhe kësti i fundit të bëhet jo më vonë se 01.06.2019. Ne kemi vërejtur se, deri në fund të vitit 2019, pagesa e mjeteve për shlyerjen e obligimeve sipas marrëveshjes ishte ekzekutuar në shumën 48,675,000€, ndërsa vlera 4,425,000€ nuk është paguar ende.

Shkak për vonesat në pagesa ishin kryesisht mungesa e mjeteve financiare, pasi që për disa nga këto projekte në vitet e mëparshme ishin lidhur kontrata pa fonde të mjaftueshme.

[15] (1). Lënda 216,302€, projekti nr. 15086 data e pagesës, 15.03.2019 ndërsa fatura 19.09.2018. (2) Lënda me vlerë 49,297€, projekti nr. 13618, data e pagesës 22.03.2019, data e faturës 16.10.2018 (Një pjesë e obligimit për këtë projekt ishte paguar me datën 23.10.2018, mirëpo si obligim kishte mbetur vlera 49,296€ ndërsa ishte paguar 136,361€). (3) Lënda me vlerë 88,992€, projekti nr.15019 , data e pagesës 12.03.2019, ndërsa data e faturës 24.12.2018. (4) Lënda me vlerë 20,236€, projekti nr.15306, data e pagesës 24.07.2019 ndërsa data e faturës 14.03.2019, (5) Lënda me vlerë 10,546€, projekti nr.14738, data e pagesës 04.04.2019, ndërsa data e faturës 12.10.2018 dhe (6) Lënda me vlerë 45,703€, projekti nr.15347, data e pagesës 27.11.2019, ndërsa data e faturës 02.09.2019.

[16] Faturat: (1) 281,593€ ekzekutuar me 11 ditë vonesë, (2) 83,410€ – 39 ditë vonesë, (3) 12,283€ – 54 ditë vonesë, (4) Obligimi për energji elektrike 53,126€, nga 31 faturat në vlerë prej 57,341€ ishin paguar vetëm 4,216€.

Ndikimi Mos rrespektimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve, mund të rezultojë me harresë për pagesën e faturave dhe rrjedhimisht MI, mund të mos ketë informacionin e duhur dhe në kohë lidhur me obligimet paraprake. Kjo, po ashtu, mund të ndikojë në ecurinë e realizimit të projekteve si dhe në padi eventuale nga OE.

Rekomandimi A13 Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt ka fonde të mjaftueshme të planifikuara, në mënyrë që kjo të mos reflektohet në kryerjen e obligimeve ndaj OE. Njëkohësisht të rrit kontrollet lidhur me sistemin e menaxhimit të faturave, ashtu që të gjitha pagesat e faturave të bëhen në përputhje me afatet kohore ligjore.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2019 ishte 22,274,580€. Këto kanë të bëjnë me rastet ku MI është në procedurë gjyqësore si e paditur dhe ende nuk ka një vendim final.

2.4.3 Detyrimet kontraktuese

Ministria nuk ka raportuar të dhëna mbi obligimet kontraktuese. Megjithatë, duke pasur parasysh se MI ka projekte ende të pa përfunduara, detyrimet kontraktuese janë evidente. Mirëpo, për shkak që zyrtarët kompetent nuk kanë ofruar të dhëna konkrete për këto detyrime, ne nuk ishim në gjendje të paraqesim vlera financiare.

2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm është i themeluar me Statutin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB). NjAB operon me dy anëtar dhe Drejtorin e Auditimit. Pozicionimi i NjAB në strukturën organizative i shërben misionit të saj të përcaktuar me statut. Plani i Auditimit të Brendshëm parasheh 10 auditime të rregullta të përcaktuara sipas prioritetit të lartë (7) dhe të mesëm (3). Gjatë vitit 2019 kanë arritur të realizohen 7 dhe një auditim ad hoc. Sa i përket fushëveprimit, një auditim ishte përqendruar në aktivitetet e 2019, një 2018/19, katër për 2018 dhe dy për 2017/18. MI ka të themeluar Komitetin e Auditimit mandati i të cilit përcaktohet me Statutin e Komitetit. Në funksion të realizimit të kërkesave ligjore gjatë vitit kishte mbajtur gjithsej 4 takime.

Ne kemi ekzaminuar planin e zbatimit të rekomandimeve dhe sipas raporteve të AB gjatë vitit janë dhënë 52 rekomandimeve, dhe prej tyre, deri në kohën e zbatimit të auditimit ishin zbatuar 50%. NjAB ka hartuar raporte të rregullta periodike për aktivitetet e saj.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Ministrisë së Infrastrukturës ka rezultuar në 16 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Ministria nuk ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar; një (1) ishte në proces dhe tetë (8) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në vijim Tabelën e rekomandimeve.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për për Theksim të Çështjes së opinion dhe eliminimin e tyre. Prandaj, veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet për të eliminuar keq klasifikimet dhe pagesat e parregullta, që duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjeve në fuqi.	Çështja lidhur me keqklasifikimin ishte aktuale edhe në 2019. Po ashtu, edhe këtë vit Ministria kishte të angazhuar 32 persona pa vijueshmëri në punë. Përderisa çështjet tjera të ngritura janë zbatuar.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
2	PVF	Po ashtu, duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së PFV të vendos proceset efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Të siguroj se do të ndërmerren hapa për të siguruar të prezantim te saktë të obligimeve të papaguara, siç kërkohet me rregullat e Thesarit.	Në PF-të 2019 kishte nevojë për korrigjime. Edhe në PF finale janë identifikuar mangësi.	Rekomandim i pazbatuar
3	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të ndërmerrë veprime për funksionalizmin me kohë të njësive zbatuese të projekteve, në mënyrë që projektet kapitale të realizohen konform marrëveshjeve të arritura.	Duke iu referuar çështjeve të ngritura edhe në vitin 2019 figuron situatë e njëjtë.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar

4	Paga dhe mëditje	Ministri duhet të siguroj që angazhimi i stafit me MSHV bëhet në pajtim të plotë me kërkesat e rregulloreve, respektivisht procedurat zbatohen me transparencë e plotë, duke marrë parasysh përgatitjen profesionale dhe performancën e kandidatëve të rekrutuar. Veç kësaj, në koordinim me MF dhe MAP të rishikojnë mundësinë që pozitat e rregullta të plotësohen sipas Ligjit për shërbimin civil.	Nga MI nuk janë ndërmarrë veprime korrigjuese lidhur me këtë çështje.	Rekomandim i pazbatuar
5	Mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale	Ministri duhet të siguroj se janë vendos kontrolle efektive financiare dhe të arrihet një koordinim më i mirë ndërmjet njësisë kërkuese, menaxherit të kontratave, dhe zyrës së prokurimit, në mënyrë që të gjitha obligimet të paguhen me kohë dhe të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë vonesa dhe shpenzime të përmbarimit.	Nga evidencat e pranuara nuk ka pasur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
6	Investime kapitale	Ministri duhet sigurohet së zyrtarët e saj duhet të jenë pjesë e komisioneve në procesin hapjes dhe vlerësimit të ofertave, për t'u siguruar se proceset e prokurimit zhvillohen në kuadër të një transparence të plotë dhe në pajtim me rregulloret, si dhe të informohet me dinamikën e projekteve.	Duke u bazuar në testimet e zhvilluara nuk janë ndërmarrë veprime korrigjuese nga MI.	Rekomandim i pazbatuar
7	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj që para se të arrihen marrëveshjet me Komunat për bashkëfinancimin e projekteve të caktuara, të sigurohet se komunat kanë rregulluar çështjet pronësore, kopjen e planit dhe pëlqimet për kyçje nga kompanitë komunale (rryma, uji dhe kanalizim). Në të kundërtën, të mos bëhet financimi i tyre.	Testimet kanë identifikuar 2 projekte që kishin vonesa në realizim si shkak i mos shpronësimit, mirëpo janë kontrata nën menaxhimin e MI-së. Këto dy çështje janë trajtuar tek realizimi i ulët i buxhetit.	Rekomandim i pazbatuar

8	Investime kapitale	Ministri duhet t'i rishikoj dy rastet e mësipërme dhe të analizoj pse kanë ndodhur parregullsitë e përmendura, si dhe të siguroj se Departamenti i prokurimit do të zbatoj me përpikëri të gjitha kërkesat e rregulloreve të prokurimit në të ardhmen.	Rekomandimi është marrë parasysh pasi edhe testimet nuk kanë identifikuar raste.	Rekomandim i zbatuar
9	Investime kapitale	Ministri duhet ta shqyrtoj rastin e mësipërm dhe të fuqizoj kontrollet dhe masat e përgjegjësisë në zyrën e prokurimit, që nënshkrimi i kontratave të behët në pajtueshmëri të plotë me afatet kohore të publikuara në njoftimin për kontratë, dhe praktikat e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.	Testimet nuk kanë identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
10	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura që zyra e prokurimit të ofroj siguri se zhvillimi i proceseve të prokurimit që nga inicimi i aktiviteteve, deri në nënshkrimin e kontratave, zhvillohet brenda kornizës ligjore, apo në mënyrë specifike të kërkoj nga menaxheri i prokurimi të mos nënshkruhen kontratat pa dëshmitë për sigurinë e ekzekutimit të projekteve.	Testimet nuk kanë identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
11	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj se para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë matjet gjeodezike, incizimi i gjendjes reale në terren, zgjidhja e çështjeve pronësore dhe përcaktimi i saktë i trasesë së rrugëve. Më pas, të përcaktohet paramasa dhe parallogaria e projektit, në mënyrë që të reduktohet mundësia e tejkalimit të punimeve të parapara me kontratë.	Nuk kemi identifikuar raste te tilla.	Rekomandim i zbatuar
12	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj se në rastet kur imponohet nevoja e korrigjimeve teknike në projekte, procesi i ri hartimit të projekteve bëhet vetëm pasi të jenë zhvilluar procedurat e prokurimit, apo nga kompanitë që janë të kontraktuara nga Ministria.	Testimet nuk kanë identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar

13	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar në pajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.	Çështjet e ngritura tregojnë se situatë e njëjte vazhdon në MI sa i përket komisioneve për pranimin e punëve.	Rekomandim i pazbatuar
14	Investime kapitale	Ministri duhet siguroj se me rastin zhvillimit të procedurave të prokurimit kur kemi të bëjmë me furnizime apo me punë ku dihen sasitë e përafërta, të merr në konsiderim sugjerimet paraprake të njësive kërkuese të prokurimit për llojin e kontratave dhe procedurat për të parandaluar mundësinë e manipulimeve.	Testimet nuk kanë identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
15	Pasuri kapitale dhe jo kapitale	Ministri duhet të siguroj që anëtarët e komisionit për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë, dhe zyrtarë për menaxhimin e pasurive të emërohen nëpunës kompetent dhe profesional që do të mundësonin inventarizimin e plotë, raportimin dhe menaxhimin e pasurive në pajtim me kërkesat ligjore.	Procesi i inventarizimit ishte me vonesë megjithëse në fund kishte hartuar një raport final pas datës së PF-ve.	Rekomandim i pazbatuar
16	Obligimet e papaguara	Ministri së pari duhet të siguroj se ekzistojnë fondet e sigurta për pagesën e obligimeve të mbetura nga vitet e mëhershme, dhe se të gjitha faturat e arritura gjatë vitit, do të paguhen brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Për MI-në vazhdon të jetë sfidues menaxhimi i obligimeve. Megjithëse raportimet janë të rregullta ato përcillen me mangësi në aspektin e plotësisë.	Rekomandim i pazbatuar

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Opinioni i auditimit	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë çështje ta diskutoj edhe në Qeveri.
2	Opinioni i auditimit	Ministri të siguroj se në rastet e kompensimeve të personelit të ndiqet mënyra e rregullt sipas formës dhe shtesës të cilat janë buxhetuar në kategorinë e duhur, si dhe të shqyrtohen vendimet e marra lidhur me rastet e ngjashme në mënyrë që të sigurohet se nga Ministria janë ndërmarrë veprime ligjore.
3	PVF	Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2020 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet

		e keqklasifikimeve, prezantimit të të dhënave te raportimi i ekzekutimit të buxhet si dhe shpalosjeve në PVF.
4	Paga dhe mëditje	Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të dispozitave ligjore të sipër përmendura në lidhje me procedurat e rekrutimit dhe anulimin e konkursit, dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës për veprimet apo mos veprimet e tyre të nevojshme për të siguruar kompetencën profesionale për zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.
5	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj se janë marrë masa për qartësimin e ligjshmërisë së këtyre njësive, të rishikohen vendimet për themelimin e tyre si dhe të ndërmerren veprimet konkrete, duke shtuar kontrollin dhe ngritur nivelin e llogaridhënies në pajtim me kërkesat rregullative.
6	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj një rishikim të sistemit të kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin dhe procesimin e pagesave për NjZP-të, për të siguruar besueshmëri lidhur me shfrytëzimin e burimeve buxhetore, duke përfshirë edhe ato nga fondi i huamarrjes.
7	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj se është kërkuar llogaridhënie duke identifikuar rastet e tilla dhe se janë marrë masa në vënien e kontrollit, duke rishikuar përbërjen e anëtarëve në NjZP, të cilat duhet të jenë në harmoni me kërkesat sipas marrëveshjeve të aprovuara me huadhënësi dhe të parandalojnë angazhime të tilla në të ardhmen.
8	Mallra dhe shërbime	Ministri të ndërmerr masa në shtimin e kontrollit në administratë, në mënyrë që të njoftohen zyrtarët përkatës rreth kryerjes së obligimit për mbylljen e avanseve me kohë, ashtu të rritet përgjegjësia e zyrtarëve të cilën përfshihen në këto lloj shpenzime.
9	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj mbikëqyrje efektive të projekteve, në mënyrë që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim të plotë me kushtet e kontratës dhe pagesat të kryhen vetëm për punët e ekzekutuara. Po ashtu, të siguroj se menaxherët e kontratave për çdo ndryshim në kushte të kontratës gjatë zbatimit të projektit, bëhet vetëm pas aprovimeve paraprake të marra nga njësia kërkuese dhe ZKA.
10	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj se çdo ndryshim në kushte të kontratës gjatë zbatimit të projektit bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit, aprovimeve paraprake të marra nga ZKA dhe njësia kërkuese.
11	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj se obligimet kontraktuese krijohen vetëm brenda kufijve të ndarjeve vjetore të buxhetit. Në rastet kur kontratat janë shumëvjeçare, kjo të parashihet edhe me kornizën afatmesme të shpenzimeve, dhe zotimi i fondeve të bëhet deri në shumat që planifikohet se do të jetë progresi i kontratave.
12	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar në pajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.

13	Investime kapitale	Ministri duhet sigurohet se pjesë e komisioneve në procesin hapjes dhe vlerësimit të ofertave, duhet të jenë të përfshirë edhe zyrtarë të ministrisë, apo siç parashihet me marrëveshjet përkatëse, për t'u siguruar se proceset e prokurimit zhvillohen në kuadër të një transparence të plotë dhe në pajtim me rregulloret, si dhe të informohet me dinamikën e projekteve.
14	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj se zyrtari certifikues, gjatë procesimit të pagesave të sigurohet se në dosje është e bashkangjitur pjesa financiare e kontratës dhe çertifikimi i pagesës do të bëhet vetëm në bazë të situacioneve të cilat paraqesin punët në mënyrë specifike që ndërlidhen me faturë, dhe të dëshmuara me dokumentacionin relevant.
15	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministri duhet të siguroj se janë evituar shkaqet që ndikojnë në vonesa dhe mangësi në procesin e inventarizimit të pasurive që do të mundësonin raportimin e drejtë të vlerës financiare të pasurive sipas kërkesave ligjore.
16	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministri duhet të siguroj se ekzistojnë kontrolle funksionale të cilat sigurojnë që regjistri i pasurive azhurnohet sipas klasifikimit të duhur duke reflektuar vlerën e saktë të prezantuar. Po ashtu, të sigurohet mbështetje e duhur në trajnimin e personelit të angazhuar në menaxhimin e pasurisë.
17	Të arkëtueshmet	Ministri duhet të ndërmerr veprime për të identifikuar arsyet e vonesave si dhe mos pagesave nga debitorët e të arkëtueshmeve dhe të krijojë mekanizma duke ndërmarre veprime konkrete për inkasimin e tyre.
18	Detyrimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve.
19	Detyrimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt ka fonde të mjaftueshme të planifikuara, në mënyrë që kjo të mos reflektohet në kryerjen e obligimeve ndaj OE. Njëkohësisht të rrit kontrollet lidhur me sistemin e menaxhimit të faturave, ashtu që të gjitha pagesat e faturave të bëhen në përputhje me afatet kohore ligjore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes

Shtojca II: Letër e konfirmimit





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastrukture

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



z. Arban Abrashi

Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës,

Data: 22. Qershor 2020, Prishtinë